



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 15

Prishtinë, më 26 prill 2010, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Adem Hajdaraj, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Selville Halimi, Radmila Vujović, Kolë Berisha dhe Mufera Şinik

Mungoi: Bajram Kosumi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Gani Koci – kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lulzim Alijaj – ZKM, Burim Balaj - MAP, Arben Krasniqi, - MAP, Besnik Ramadanaj – KDI, Friderike Björnsson – ECLO, Petrit Hysaj – OSBE, Lejla Selimi – OSBE, Vlora Marmullakaj – EULEX, Lumnije Murati – ZPRK, Albulena Ademi dhe Dafina Bardhi – praktikante.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Sulltane Gashi dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 19 prillit 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë,
5. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për shërbimin civil në Republikën e Kosovës,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që nga rendi i ditës të hiqet pika *Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit për Ndihme Juridike për vitin 2009*. Propozoi të fillohet me shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime

2. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për shërbimin civil në Republikën e Kosovës

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe mbikëqyrësit e punës së Komisionit. E ftoi Gani Kocin të jepte arsyetimin rreth amendamenteve në Projektligjin për shërbimin civil dhe në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë.

Gani Koci - Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa e paraqiti arsyetimin për amendamentet në Projektligjin për shërbimin civil dhe në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë. Theksoi se në Projektligjin për shërbimin civil janë bërë ndryshime të mëdha, që janë në kundërshtim me konceptet që kanë qenë për reformën në shërbimin civil, pra është ndryshuar mbi 60% e Projektligjit. Implikimet në Projektligjin për shërbyesit civilë janë enorme dhe janë jashtë çdo mundësie të parashikuar me Kornizën afatmesme. Ndërsa duke folur për Projektligjin për pagat tha se nuk e përcakton nivelin e pagave, por i përcakton parimet e përgjithshme me çka do të shpërblehet një shërbyes civil. Shtoi se këtu janë futur disa shpërblime, që nuk parashihen me asnjë konventë. Po ashtu janë përfshirë shujta dhe transporti. Me këto ngarkesa llogariten mbi 50 milionë euro në vit. Këtë nuk e përballon buxheti i Kosovës.

Adem Hajdaraj - U pajtua me parafolësit se ka ngarkesa buxhetore, por pyeti a shkelet marrëveshja e shërbyesve civilë dhe a mund të shkaktohen protesta të sindikatave të ndryshme?

Gani Koci dha sqarime shtesë në pyetjet e shtruara nga anëtarët e Komisionit lidhur me transportin e shërbyesve civilë.

Ibrahim Makolli - U pajtua me parafolësin se nuk ka asnjë standard, që parasheh se duhet të transportohen punëtorët për në vendin e punës. Edhe në kohën, kur kishte transport të tillë, ishte abuzim i parasë publike. Nëse për dikë sigurohet transporti, duhet të sigurohet për të gjithë shërbyesit që paguhën nga buxheti i Kosovës, do të thotë afërsisht për 70 mijë. Në sistemet demokratike nuk gjendet një standard i tillë.

Lulzim Alijaj – ZKM - Kam qenë pjesë e grupit kur është hartuar drafti i parë, i cili i ka kaluar të gjitha rishqyrtimet e Komisionit Evropian, të Bankës Botërore, të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të *Sigmës*. Kjo ndarje është bërë me qëllim që të rregullohet statusi i shërbyesve civilë, në mënyrë që të mos përfshihen nëpunësit e administratës publike. Këto amendamente, si të tilla, pothuajse e ndryshojnë përmbajtjen e Projektligjit.

Adem Salihaj - Nëse ndalemi dhe e analizojmë secilin amendament veç e veç, nuk do të arrijmë të përfundojmë brenda kësaj mbledhjeje.

Selvije Halimi - Theksoi se nuk do të ishte mirë të lihet mundësia që të mos votohen amendamentet në Kuvend, sepse mjafton të kalojë një amendament dhe kështu ligji të mbetet jashtë sistemit. Ka disa amendamente që janë në kundërshtim me Ligjin për zyrtarët e lartë publikë, me Ligjin për prokurimin publik dhe me Kushtetutën. Ishte e mendimit të rekomandohet të bëhet edhe leximi i tretë.

Diskutime u zhvilluan për amendamentet 2, 4, 47, 48, 49, 50, 52, 54, 55, e kështu me radhë. Me këtë rast Komisioni i veçoi kundërshtitë në këto amendamente.

Lidhur me kundërthëniet e këtyre amendamenteve diskutuan: Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

Komisioni vlerësoi se amendamentet e Komisionit Funkcional janë në kundërshtim njëra me tjetrën dhe me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.

Pas një debati Komisioni njëzëri u pajtua që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

- 1. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk i mbështet amendamentet e Komisionit Funkcional.*
- 2. Komisioni i rekomandon Kuvendit ta miratojë tekstin e Projektligjit të miratuar në parim ose të vendosë për lexim të tretë, që të harmonizohen amendamentet.*
- 3. Arsyetimin e Raportit e paraqet kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni.*

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë

Kryetari – I paraqiti propozimamendamentet në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë, të cilat mund të përkrahen nga Komisioni, sepse nuk bien ndesh me ligjet e tjera. Pati të vetmen vërejtje që të kërkohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të japë sqarime lidhur me amendamentin 47, se a është i përballueshëm në aspektin financiar.

Pas një debati Komisioni njëzëri u pajtua që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë këtë

REKOMANDIM

- 1. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi konstatoi se amendamentet në Projektligjin për pagat e nëpunësve civilë nuk bien ndesh me ligjet e tjera.*
- 2. Kërkohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të deklarohet për amendamentin 47 a është i përballueshëm në aspektin financiar.*
- 3. Arsyetimin eventual të Raportit e paraqet kryetari i Komisionit Bahri Hyseni.*

Mbledhja përfundoi në orën 13:05

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni